



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KESHILLI

Nr. 3800 / prot

Koplik më: 21/12 / 2022

**V E N D I M**

*Nr 71 datë 21 / 12 / 2022*

Këshilli Bashkiak Malësi e Madhe në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, mbështetur në aktin normativ nr 3 datë 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015. "Për vetëqeverisjen vendore" neni 9 pika 1.7/a, të Ligjit 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë" seksioni 3 neni 14, neni 15 pika 1/a, pika 2/b, neni 16/1.

VKM Nr.861 datë 10.12.2014 Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve për dhënien e medaljeve dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë.

**V E N D O S I**

1. T'i akordojë titullin "Qytetar Nderi" Z. **Tom Therçaj** me motivacionin:

"Për punën dhe përkushtimin e tij si një qytetarë bashkëkohorë, si gazetarë dhe producent me shumë përvojë, si një përfaqësues i denjë i kulturës malësore, shqiptare e ndërkombëtare ku edhe pse prej kohësh në Tiranë nuk e ndau asnjëherë vendlindjen e tij, por duke e lartësuar kurdoherë trevën tonë Malësi e Madhe e më gjërë".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

Ilir Halaj

**SEKRETAR**

Emirjan Hasmujaj

Miratuar me 21.12.2022

Vota Pro 22

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 22.12.2022

